



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 dhjetor 2021
Nr.ref.:AGJ 1930/21

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO127/21

parashtrues

Abelard Tahiri dhe 10 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-029, të Kuvendit të Republikës së Kosovës i 30 qershorit 2021, për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga njëmbëdhjetë (11) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), përkatësisht: Abelard Tahiri, Eliza Hoxha, Ganimete Musliu, Blerta Deliu Kodra, Hajdar Beqa, Fadil Nura, Ardian Kastrati, Elmi Reçica, Floretë Zejnullahu, Ariana Musliu Shoshi, Bekim Haxhiu (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës ose deputetët parashtrues).
2. Parashtruesit e kërkesës përfaqësohen në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), nga përfaqësuesi ligjor Faton Fetahu nga Prishtina.

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Vendimin [nr.08-V-029] të 30 qershorit 2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Vendimi i kontestuar) për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli i Pavarur).

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, i cili sipas pretendimit të parashtruesve të kërkesës, nuk është në pajtueshmëri me nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe nenin 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se bazuar në nenin 43 (Afati) të Ligjit, Vendimi i kontestuar i nënshtrohet efektit pezullues *ex-lege*. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës i referohen edhe (i) paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton që përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme; dhe (ii) nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit, i cili përcakton që Gjykata, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës, mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji); si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.5

të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 7 korrik 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatë, përmes së cilës, kontestuan Vendimin e Kuvendit për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur.
8. Më 14 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
9. Më 16 korrik 2021, Gjykata për regjistrimin e kërkesës e njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit dhe kërkoi që deri më 30 korrik 2021, të dorëzojnë në Gjykatë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me Vendimin e kontestuar.
10. Më 16 korrik 2021, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës: Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetari i Kuvendit), të cilit iu kërkua që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit; Avokatin e Popullit dhe Këshillin e Pavarur. Gjykata i njoftoi palët e interesuara të cekura më lart se komentet e tyre, nëse kanë, t'i paraqesin në Gjykatë, brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor, përkatësisht deri më 30 korrik 2021, në adresën elektronike të Gjykatës ose me dorëzim personal.
11. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës edhe Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja) si dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri).
12. Më 21 korrik 2021, Sekretari i Kuvendit dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë lidhur me Vendimin e kontestuar.
13. Më 30 korrik 2021, deputetja Doarsa Kica-Xhelili, deputete nga Grupi Parlamentar VETËVENDOSJE!, dorëzoi komentet në lidhje me kërkesën KO127/21.
14. Më 3 gusht 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për pranimin e komenteve nga deputetja Kica-Xhelili, si dhe u ofroi mundësi që të ofrojnë komentet e tyre deri më 13 gusht 2021. Parashtruesit e kërkesës nuk dorëzuan komente shtesë.
15. Më 15 shtator 2021, Gjykata kërkoi nga Këshilli i Pavarur dokumente shtesë, përkatësisht (i) kopjen e dorëheqjes së z. Eshref Shabani nga pozita e Kryetarit të Këshillit të Pavarur; dhe (ii) çdo dokument tjetër relevant të 8 shtatorit 2021, përkatësisht të mbledhjes së jashtëzakonshme të këtij institucioni, lidhur me çështjen e dorëheqjes.

16. Më 17 shtator 2021, Këshilli i Pavarur bashkëngjiti (i) Vendimin e Këshillit të Pavarur nr.7/2021 të 8 qershorit 2021; (ii) Kopjen e Procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të Këshillit të 8 qershorit 2021, në të cilën e vetmja pikë e rendit të ditës ishte shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Këshillit të Pavarur për dorëheqje nga kjo pozitë; dhe (iii) Vendimin e Kuvendit për shkarkimin e 5 (pesë) anëtarëve të Këshillit të Pavarur.
17. Më 6 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri kërkoi shtyrjen e rastit për plotësime shtesë, ndërsa përkitazi me vlerësimin e masës së përkohshme, marrjen e informatave nga Kuvendi lidhur me veprimet e ndërmarra pas miratimit të Vendimit të kontestuar.
18. Më 12 tetor 2021, Gjykata kërkoi nga Kuvendi informata shtesë lidhur me veprimet e ndërmarra pas Vendimit të kontestuar.
19. Më 13 tetor 2021, Kuvendi ktheu përgjigje me informatat e kërkuara nga Gjykata, duke e informuar Gjykatën lidhur me shpalljen e konkurseve, përkatësisht Vendimin e Kryesisë së Kuvendit për shpalljen e konkursit për pesë (5) anëtarë të Këshillit nga 23 gushti 2021; dhe Vendimin e Kryesisë së Kuvendit për rishpalljen e konkursit për pesë (5) anëtarë të Këshillit nga komuniteti shqiptar dhe për dy (2) anëtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë nga 6 tetori 2021.
20. Më 20 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi propozimin e Gjyqtarit raportues përkitazi me vendimin për masën e përkohshme dhe njëzëri kërkoi plotësimin e mëtejme të këtij propozimi.
21. Më 21 tetor 2021, Gjyqtari raportues i rekomandoi Gjykatës miratimin e masës së përkohshme. Po të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri vendosi masën e përkohshme përkitazi me Vendimin e kontestuar deri më 15 dhjetor 2021.
22. Më 24 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri kërkoi shtyrjen e rastit për plotësime shtesë.
23. Më 9 dhjetor 2021, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi dhe njëzëri vendosi se Vendimi [nr. 08-V-029] i 30 qershorit 2021 i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

24. Më 8 tetor 2020, pas tri raundeve të votimit të fshehtë, Kuvendi përmes Vendimit [Nr.07-V-063], vendosi për zgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Ky vendim ishte bazuar në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës, nenet 8 (Përbërja e Këshillit), 10 (Procedura për emërimin e anëtarëve të Këshillit) dhe 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit

nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për KPMSHCK-në), si dhe nenet 51 dhe 84 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

25. Më 31 mars 2021, bazuar në paragrafin 1 të nenit 28 (Raporti vjetor i Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-së, Këshilli i Pavarur i paraqiti Kuvendit Raportin Vjetor të Punës së tij për vitin 2020.
26. Më 28 prill 2021, Kryetari i Kuvendit: (i) ua përcolli Raportin Vjetor të Këshillit të Pavarur deputetëve të Kuvendit, si dhe (ii) ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal (në tekstin në vijim: Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike) dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, që t'a shqyrtojnë këtë raport dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet respektive me rekomandime.
27. Më 1 qershor 2021, u mbajt mbledhja e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, ku me gjashtë (6) vota kundër, u votua kundër miratimit të Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur për vitin 2020.
28. Më 2 dhe 3 qershor 2021, Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike përmes Zyrës Koordinuese të Komisionit i kërkoi Këshillit të Pavarur informatat si në vijim: (i) të dhënat për të gjitha lëndët që kanë qenë në pritje para se Këshilli i Pavarur të vendoste për lëndën që ishte diskutuar në Komision (rasti i N.K.-së), përfshirë por pa u kufizuar në evidentimin e numrit të lëndëve paraprake para se të vendoset për këtë rast; dhe (ii) numrin e saktë të të gjitha lëndëve në pritje, datat e sakta të parashtrimit të secilës ankesë/kërkesë/parashtrësë që ka qenë në pritje dhe është dorëzuar para lëndës së N.K.-së, e që megjithatë nuk është trajtuar para kësaj lënde. Po ashtu, ky Komision kërkoi edhe informatat si në vijim: (i) a janë trajtuar të gjitha rastet që u evidentuan si në pritje në pyetjen paraprake, brenda afatit dyzet e pesë (45) ditësh; dhe (ii) të konfirmohet në qoftë se të gjitha këtyre rasteve nuk ka pasur nevojë t'i jepet kohë shtesë për trajtim, por ka mjaftuar afati në fjalë apo ajo që ka mbetur nga ky afat me rastin e bartjes. Me rastin e dërgimit të këtij sqarimi, Zyra Koordinuese e Komisionit kërkoi që (i) t'i dërgohen edhe data e vendimmarrjes për rastet që u identifikuan si në pritje në pyetjen paraprake; dhe (ii) të bashkëlidhin dosjen e plotë të rastit të N.K.-së.
29. Më 7 qershor 2021, Kryetari i Këshillit, Eshref Shabani, ktheu përgjigje në kërkesën e lartcekur duke theksuar që: (i) Këshilli i Pavarur është i paraparë në bazë të paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës, ku përcaktohet se *"një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës"*; (ii) ofroi informata lidhur me mënyrën e ndarjes së lëndëve tek anëtarët e Këshillit të Pavarur, si dhe vendosjen e rasteve në kolegje të përbëra nga tre anëtarë që ishin vendosur me Vendimin e KPMSHCK-së [Nr.2] të 14 tetorit 2020, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 3 të nenit 16 (Shqyrtimi i ankesave) të Ligjit për KPMSHCK-në; dhe (iii) ofroi informata lidhur me lëndën e ankuesit N.K., ku theksoi që ankesa e këtij të fundit ishte pranuar më 7 shkurt 2019 dhe ishte

ankesa e 77-të e pranuar në vitin 2019. Më tej, sqaroi si kjo ankesë i ishte ndarë atij dhe se lënda është trajtuar bazuar në radhën e rasteve të vitit 2019 që i ishin caktuar, prandaj nuk i ishte dhënë ndonjë prioritet në trajtim të rastit, duke sqaruar gjithashtu se si është propozuar zgjatja e afatit të vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë, bazuar në paragrafin 2 të nenit 17 (Afati i vendimmarrjes në Këshill) të Ligjit për KPMSHCK-në.

30. Më 8 qershor 2021, Këshilli i Pavarur mbajti mbledhjen e jashtëzakonshme dhe nxori Vendimin nr.7/2021, përmes së cilit theksohet se z. Eshref Shabani ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e kryetarit të Këshillit të Pavarur dhe përmes së cilës vendoset që z. Arben Mehmeti kryeson Këshillin deri në zgjedhjen e kryetarit të ri. Sipas komenteve të Këshillit të Pavarur të 15 shtatorit 2021, procesverbali ka mbetur i pa miratuar nga Këshilli sepse anëtarët ishin shkarkuar. Gjykata, vëren se bazuar në shkresat e lëndës, z. Shabani kishte dhënë dorëheqje nga pozita e Kryetarit të Këshillit të Pavarur, e jo nga pozita e anëtarit.
31. Më 10 qershor 2021, Këshilli i Pavarur njoftoi Komisionin e Kuvendit për Administratë Publike se: (i) Eshref Shabani kishte dhënë dorëheqje nga pozita e Kryetarit të Këshillit; dhe se (ii) në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit të Pavarur të 8 qershorit 2021, u aprovua dorëheqja e tij dhe në bazë të dispozitave të Rregullores së Punës 01/2018 për KPMSHCK-në, u vendos që deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri, Kryesues të jetë Arben Mehmeti.
32. Më 15 qershor 2021, Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike nxori Rekomandimin [08/314/Ra-11] që: *“1.Të mos miratohet Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2020,”* me arsyetimin që Raporti nuk i përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon mos miratimin e tij.
33. Në të njëjtën ditë, Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike, me gjashtë (6) vota *“për”* dhe katër (4) *“kundër”* përmes Rekomandimit [08/315/Do-213], i rekomandoi Kuvendit që të shkarkojë pesë (5) anëtarët e Këshillit të Pavarur. Në arsyetimin e rekomandimit u theksua që iniciimi i procedurës së shkarkimit u bë sipas paragrafit 1, pikat 1 dhe 3 të nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në si në vijim, përkatësisht (i) për shkelje të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në; dhe (ii) në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij. Për më tepër, në rekomandimin përkatës u theksua se: *“është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsyet se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes”*.
34. Më 17 qershor 2021, Këshilli i Pavarur i drejtohet Kuvendit përmes parashtresës ku shpreh shqetësimin e anëtarëve të Këshillit lidhur me iniciativën për shkarkim të anëtarëve të KPMSHCK-së në arsyetimin që: (i) Këshilli i Pavarur është institucion i pavarur i përcaktuar në nenin 101 të Kushtetutës; (ii) anëtarët e Këshillit të Pavarur lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi; (iii)

theksojnë që Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike nuk ka ekspertizë dhe njohuri të nevojshme që të shqyrtojë lëndë konkrete siç kanë bërë anëtarët e këtij Komisioni; dhe (iv) në përputhje me Ligjin nr.03/L-176 për Hetim Parlamentar, të iniciohet themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar dhe ky Komision të merret me analizën e hollësishme të vlerësimit të punës së anëtarëve të Këshillit të Pavarur.

35. Më 30 qershor 2021, në seancën plenare të Kuvendit u votua lidhur me rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Rezultati i votimit ishte si në vijim: gjashtëdhjetë e dy (62) vota “për” shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur, tre (3) vota “kundër” dhe njëmbëdhjetë (11) vota “abstenime”. Rrjedhimisht, Kuvendi përmes Vendimit [Nr.08-V-029], votoi shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të KPMSHCK-së.
36. Me 19 korrik 2021, Kryesia e Kuvendit përmes Vendimit [nr.08-V-049] vendosi që nga 23 gushti 2021, të shpallet konkursi për pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur, nga komuniteti shqiptar. Përderisa, brenda afatit prej njëzet e një (21) ditësh, deri me 13 shtator 2021, nuk kishin aplikuar kandidatë të mjaftueshëm, Kryesia e Kuvendit, me 29 shtator 2021, përmes Vendimit [Nr.08-V-065], rishpalli konkursin publik për pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur nga komuniteti shqiptar dhe për dy (2) anëtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë. Konkursi u shpall më 6 tetor 2021 dhe mbeti i hapur deri më 25 tetor 2021.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

37. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi i kontestuar i Kuvendit në aspektin përmbajtësor dhe procedural, është në kundërshtim me nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.
 - (i) *Pretendimet lidhur me pranueshmërinë e kërkesës*
38. Parashtruesit e kërkesës, theksojnë se bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës KO73/16, dhe veçanërisht paragrafët 43 dhe 49 të tij, Vendimi i kontestuar ngre çështje kushtetuese sepse hyn në sfondin e normave të përcaktuara përmes neneve 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.
39. Parashtruesit e kërkesës, argumentojnë se Gjykata Kushtetuese duhet të bëjë interpretimin e normave kushtetuese kurdo që një çështje i adresohet asaj nga institucionet e mandatuara për referim dhe në rastin konkret, sipas parashtruesve të kërkesës, në mënyrë që të mbrohet sistemi i shërbimit civil, i përfaqësuar nga Këshilli “anëtarëve të të cilit sistem, në mënyrë indirekte përmes vendimit kontestues, u është cenuar siguria juridike, të cilën u ka ofruar Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili ka përgjegjësi të pavarur nga Qeveria për t’i mbrojtur parimet e shërbimit publik dhe të drejtat e shërbyesve (nëpunësve) të këtij sistemi”. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Vendimi i kontestuar të shqyrtohet në merita.

(ii) *Pretendimet lidhur me shkëljen e nenit 101 dhe 142 të Kushtetutës*

40. Parashtruesit e kërkesës fillimisht theksojnë se paragrafi 2 i nenit 101 i Kushtetutës e vendos Këshillin e Pavarur në funksionin e një institucioni të pavarur që duhet të garantojë që standardet e meritës, profesionalizmit, neutralitetit ndaj politikës dhe të karakterit civil të shërbimit civil të gjejnë shprehje në punën dhe veprimtarinë e shërbimit civil të shtetit. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Kuvendi, Qeveria dhe organet tjera politike zhvishen nga kompetencat që të ndërhyjnë në ruajtjen e integritetit profesional të shërbimit civil, sepse kjo kompetencë i është bartur një institucioni të pavarur.
41. Më tej, parashtruesit e kërkesës i referohen edhe disa Aktgjykimeve të Gjykatës, duke argumentuar se (i) Vendimet e Këshillit të Pavarur janë përfundimtare dhe, si të tilla, paraqesin titull të vlefshëm ekzekutiv; dhe (ii) procedurat para këtij organi gjysmë gjyqësor (*kuazi-gjyqësor*) duhet të respektojnë rregullat mbi gjykimin e drejtë dhe të paanshëm, duke përfshirë këtu edhe procedurën e ekzekutimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur.
42. Parashtruesit e kërkesës i referohen dhe nenit 142 të Kushtetutës, duke theksuar se i njëjti rregullon formën dhe mënyrat e themelimit të Agjencive të Pavarura dhe përcakton katër parime bazë që duhet të shoqërojnë themelimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura, përkatësisht theksojnë argumentet si në vijim: (i) Kuvendi i Kosovës është autoriteti kushtetues i cili mban tagrin e themelimit të Agjencive të Pavarura, e që për themelimin e tyre, neni 142 i Kushtetutës përcakton që Kuvendi duhet të nxjerrë ligjet përkatëse, që rregullojnë, ndër të tjera, funksionimin, dhe fushëveprimin ligjor të tyre; (ii) Kushtetuta përcakton që Agjencive të Pavarura duhet t'u garantohet që ushtrimi i funksionit të tyre ligjor të realizohet pa ndikim dhe në mënyrë të pavarur nga çdo udhëzim apo ndërhyrje e organeve tjera shtetërore, përfshirë organin që e ka themeluar; (iii) për garantimin e pavarësisë së Agjencive të Pavarura, neni 142 i Kushtetutës përcakton që ato duhet të posedojnë buxhetin e tyre të veçantë, dhe të administrojnë me këtë të fundit në mënyrë të pavarur; dhe (iv) parimi kushtetues i cili duhet të shoqërojë themelimin e Agjencive të Pavarura, lidhet me garancionin kushtetues që organet tjera shtetërore të ruajnë pavarësinë, të bashkëpunojnë dhe t'u përgjigjen kërkesave të Agjencive të Pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre kushtetuese dhe ligjore.
43. Parashtruesit e kërkesës i referohen dhe Ligjit për KPMSHCK-në, duke theksuar se: (i) përmes Vendimit të kontestuar në seancë plenare me shumicë votash u vendos për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur, rrjedhimisht ndërprerjen e mandatit të tyre kushtetues; (ii) janë shkarkuar në mënyrë kolektive, përkundër faktit të pakontestueshëm që anëtarët e këtij institucioni, zgjedhen individualisht në një procedurë të përcaktuar qartësisht në Kuvend, e që sipas parashtruesve të kërkesës, me këtë rast, ka pasur shkelje të procedurës që është ndjekur përkitazi me shkarkimin e tyre.
44. Më tej, parashtruesit e kërkesës i referohen nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, duke theksuar se Vendimi për

shkarkimin (ndërprerjen) e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur është kundërkushtetues sepse me rastin e shkarkimit nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet e këtij neni. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu i referohen arsyetimit të dhënë përmes Vendimin e kontestuar për *"për shkelje të dispozitave të ligjit për Këshillin; në rast të kryerjes së detyrave në papajtueshmëri të funksionit të tij"* dhe arsyetimit në Rekomandim ku thuhet *"(...) është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK-në, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes"*. Për këto arsye, në esencë parashtruesit e kërkesës theksojnë se fjala *"shkelje të dispozitave të ligjit për Këshillin"*, konsumon të gjitha, dhe në fakt nuk janë përmbushur arsyet e nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në.

45. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se nuk ekziston asnjë fakt i paraqitur në rekomandimin e Komisionit Parlamentar për Administratë Publike: (i) që dëshmon se anëtarët e Këshillit të Pavarur kanë shkelur Ligjin për KPMSHCK-në; dhe (ii) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë kryer veprimtari, që krijon konflikt të interesit, siç përcaktohet me nenin 15 të Ligjit për KPMSHCK-në; (iii) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë kryer detyrat në papajtueshmëri me funksionin e tyre, siç përcaktohet me nenin 15 të Ligjit për KPMSHCK-në; dhe (iv) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë munguar pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsyet që nuk parashihen me ligj, siç përcaktohet nenin 15 të Ligjit për KPMSHCK-në.
46. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se anëtarët e Këshillit të Pavarur dhe vetë Këshilli i Pavarur si organ i pavarur kushtetues i janë nënshtruar presionit dhe ndërhyrjeve nga ana e Komisionit Parlamentar për Administratë Publike e që sipas parashtruesve të kërkesës dëshmon tendencën për të ndërhyrë në pavarësinë e këtij institucioni. Parashtruesit e kërkesës i referohen edhe një e-maili zyrtar të dërguar me 2 qershor 2021, në adresën zyrtare të Këshillit të Pavarur, përmes të cilit janë kërkuar informacione shtesë për një rast konkret që ka qenë duke u zgjidhur pranë Këshillit të Pavarur, e që një ditë më vonë është kërkuar dosja e plotë e rastit përkatës.
47. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se edhe sipas Aktgjykimit në rastin KO171/18, neni vendimtar në rrethanat e rastit konkret, u vlerësua në tërësi në pajtim me Kushtetutën, përkatësisht paragrafi 3 i nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-së i cili thekson që: *"3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi."*
48. Duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO171/18 e veçanërisht paragrafit 247, parashtruesit e kërkesës vënë theks edhe në paragrafin 3 të nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, duke theksuar çështjen e imunitetit dhe duke cituar se *"[...] Qëllimi i imunitetit është që anëtarët e Këshillit të jenë të lirë të ushtrojnë funksionin e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre [...]"*. Parashtruesit e kërkesës theksojnë që ky Aktgjykim tashmë ka statusin e normës juridike. Për më tepër, si

shembull krahasues, citojnë dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë 29/2011, të 7 prillit 2011, duke argumentuar se shërbyesit civil nuk mund të shkarkohen nga detyra pa ofruar një arsytim të detajuar lidhur me një gjë të tillë.

49. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të (i) shpallë kërkesën e pranueshme; dhe (ii) të shpallë Vendimin e kontestuar në kundërshtim me Kushtetutën, dhe për pasojë, të njëjtin t'a shpallë të pavlefshëm.

(iii) *Kërkesa për masë të përkohshme*

50. Parashtruesit e kërkesës sa i përket masës së përkohshme, kërkojnë që Gjykata të pranojë nenin 43 të Ligjit, duke iu referuar kështu efektit pezullues *ex-lege* të zbatimit të ligjit apo vendimit të Kuvendit. Parashtruesit e kërkesës i referohen edhe paragrafit 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton që përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu vënë theks në nenin 27 (Masat e Përkohshme) të Ligjit.

51. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës: (i) kërkojnë nga Gjykata të informojë palët e përfshira që Vendimi i kontestuar pezullohet *ex-lege* dhe nuk mund të zbatohet deri në vendimin final të Gjykatës; dhe (ii) vlerësojnë se nuk është e nevojshme të kërkojnë shprehimisht pezullimin e zbatimit të aktit të kontestuar, përderisa i njëjti sipas ligjit do të duhej t'i nënshtrohej efektit pezullues në zbatim, meqë është kontestuar pranë kësaj Gjykate, në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

(iv) *Kërkesa për Seancë Dëgjimore*

52. Parashtruesit e kërkesës lidhur me shqyrtimin e rastit, bazuar në nenin 42 të Rregullores së Punës, kërkojnë mbajtjen e seancës dëgjimore lidhur me kontestimin e Vendimit për shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të KPMSHCK-së.
53. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës theksojnë se është në interes publik që të mbahet kjo seancë dëgjimore publike, për shkak se përmbajtja e Vendimit të kontestuar cenon rendin kushtetues dhe dispozitat konkrete kushtetuese që lidhen me sigurinë juridike të punonjësve të administratës shtetërore dhe publike dhe pavarësinë e një institucioni të pavarur të nivelit kushtetues.

Përmbledhja e Komenteve të Deputetes Doarsa Kica Xhelili

54. Deputetja Kica-Xhelili në komentet e paraqitura lidhur me kërkesën KO127/21, thekson që neni 101 i Kushtetutës për sa i përket lidhshmërisë me Këshillin e Pavarur, përcakton vetëm rolin e përgjithshëm të Këshillit të Pavarur në kontekst të rregullimit të shërbimit civil në Kosovë, por nuk flet për përbërjen apo mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të tij.

55. Gjithashtu, deputetja Kica-Xhelili thekson që edhe neni 142 i Kushtetutës, flet në mënyrë të përgjithësuar për Agjencitë e Pavarura. Referimi në faktin që këto agjenci kryejnë funksionet e tyre në *“mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës”*, sipas komenteve, nuk zgjeron fushëveprimin e këtij neni në interpretimin e diskrecionit të Kuvendit në vlerësimin e kushteve ligjore për emërim dhe shkarkim të anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Prandaj, sipas deputetes Kica-Xhelili është argument plotësisht i devijuar të thuhet se ushtrimi i funksionit të rolit diskrecional të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, karshi interpretimit ligjor të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në, bie në ndonjë mënyrë në spektrin e të drejtave kushtetuese. Përfundimisht, ajo vë theksin se të referuarit në nenet 101 dhe 142 të Kushtetutës, nuk përkon me dispozita të cilat përcaktojnë kriteret e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur apo Agjencive të Pavarura.
56. Në vijim, deputetja Kica-Xhelili thekson që Gjykata Kushtetuese merret me aspektin kundërkushtetues të pretendimeve të palës parashtruese, dhe jo me kundërligjshmërinë që është detyrë e gjykatave të rregullta. Përkatësisht, sipas deputetes, ligjshmëria e një vendimi, përfshirë këtu e një vendimi administrativ të një organi publik, është kompetencë lëndore e gjykatave të rregullta. Pra, ajo thekson se në rast se anëtarët e Këshillit të Pavarur do ta vlerësonin Vendimin e Kuvendit si të kundërligjshëm, do të duhej t'i drejtoheshin gjykatave të rregullta për të konstatuar kundërligjshmërinë e pretenduar të Vendimit. Ndërkohë, deputetët e Kuvendit, nuk kanë legjitimitet t'i drejtohen gjykatave të rregullta në emër të tanimë ish-anëtarëve të KPMSHCK-së, përmes konfliktit administrativ.
57. Në vijim, deputetja i referohet edhe rastit të Gjykatës KI79/19, Aktvendim për Papranueshmëri i 10 gushtit 2020, ku në paragrafin 56, theksohet si në vijim: *“(…) Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). (…)* Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, Garcia Ruiz kundër Spanjës, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KI06/17, parashtrues L. G. dhe pesë të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues Riza Dembogaj, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 qershorit 2018, paragrafi 57).”
58. Përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë, deputetja gjithashtu thekson që Gjykata ka për detyrë interpretimin përfundimtar të dispozitave të Kushtetutës. Ndërsa, juridiksioni që bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës nënkupton vlerësimin e kushtetutshmërisë së çfarëdo ligji apo vendimi. Sipas pretendimit, vendimet e Kuvendit mund të jenë objekt i vlerësimit kushtetues në aspekt procedural dhe përmbajtësor, por vetëm në kuptim të kushtetutshmërisë.

59. Për më tepër, sipas komenteve përkatëse, parashtruesit e kërkesës nuk e kanë të qartë ose qëllimisht ngatërrojnë procesin ligjvënës dhe funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, sepse qëllimisht nuk precizojnë (saktësojnë kërkesën) nëse e kontestojnë procedurën apo kontestojnë përmbajtjen e aktit. Sipas saj, në këtë mënyrë shmangin argumentimin, ngase për t'u vlerësuar një akt i Kuvendit në aspektin kushtetues do të duhej që Kushtetuta të përcaktojë shprehimisht të paktën se cila është procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Pavarur, madje edhe procedurën e shkarkimit. Në rastin konkret, përbërja, funksionimi, përgjegjësitë, mënyra e zgjedhjes dhe mënyra e shkarkimit janë përcaktuar me ligj të veçantë. Kësisoj, Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur, edhe pse akt i një organi publik, nuk përbën objekt të vlerësimit të kushtetutshmërisë.
60. Përfundimisht, deputetja thekson që kërkesa e parashtruesve të kërkesës nuk ka të bëjë me një të drejtë kushtetuese dhe për rrjedhojë nuk mund të jetë objekt vlerësimi në Gjykatën Kushtetuese.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 101 [Shërbimi Civil]

1.Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.

2.Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

[...]

Neni 142 [Agjencitë e Pavarura]

1.Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.

2.Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj.

3.Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.

LIGJI NR. 06/L-048 PËR KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Neni 4
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

[...]

2. Këshilli për punën e tij i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës, së paku njëherë në vit, dhe sa herë që i kërkohet nga Kuvendi.

Neni 6
Funksionet e Këshillit

1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore:

1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil;

1.2. mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil; (shfuqizuar me Aktgjykimin e Gjykatës KO171/18)

1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë

Neni 11
Mandati i anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit emërohen për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër.

2. Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitete politike.

3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi.

Neni 12
Detyrat e anëtarëve të Këshillit

1. Anëtarët e Këshillit kanë për detyrë që të ushtrojnë funksionin e anëtarit në mënyrë të paanshme dhe të vendosin në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

2. Anëtarët e Këshillit kanë për detyrë të ruajnë autoritetin dhe imazhin e Këshillit.

3. Secili anëtar ka për detyrë të marr pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Këshillit, si dhe të kryej punët e tjera të caktuara me ligj, me rregulloren e punës dhe aktet tjera nënligjore të Këshillit.

Neni 15 **Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit**

1. Kuvendi i Kosovës me shumicë të votave mund të shkarkojë anëtarin e Këshillit për shkak të arsyeve në vijim:

1.1. për shkelje të dispozitave të këtij ligji;

1.2. kur kryen veprimtari, që krijon konflikt të interesit dhe përkundër paralajmërimit nga organi kompetent nuk e eliminon konfliktin e interesit sipas ligjit përkatës;

1.3. në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij;

1.4. mungon pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsyet që nuk parashihen me ligj.

2. Propozimin për shkarkim të anëtarit të Këshillit, kanë të drejtë ta bëjnë:

2.1. shumica e anëtarëve të Këshillit;

2.2. Komisioni përkatës i Kuvendit për administratë publike.

Neni 16 **Shqyrtimi i ankesave**

3. Në emër të Këshillit, ankesat i shqyrton dhe i vendos Kolegji i përbërë nga tre (3) anëtarë, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit.

Neni 17 **Afati i vendimmarrjes në Këshill**

1. Këshilli brenda afatit prej dyzetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim duke e arsyetuar bazën ligjore dhe faktike të vendimmarrjes.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në rastet kur natyra e lëndës është specifike, Kryetari i Këshillit ka të drejtë të shtyjë afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Pranueshmëria e kërkesës

61. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

62. Fillimisht, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

63. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”.

64. Fillimisht, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të kontestuar në lidhje me (i) procedurën e ndjekur dhe (ii) përmbajtjen e tij, siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.

65. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kërkesa është paraqitur nga njëmbëdhjetë (11) deputetë të Kuvendit, në pajtueshmëri me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar.

66. Në vijim, Gjykata merr parasysh nenin 42 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6, të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti”.

67. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 74 [Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës, që parasheh:

“[...]

(2) *Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:*

(a) *emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose të një vendimi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;*

(b) *dispozitat e Kushtetutës ose të aktit tjetër ose legjislacionit relevant për këtë kërkesë; dhe*

(c) *provat mbi të cilat mbështetet kontesti.*

(3) *Parashtruesit i bashkëngjisin kërkesës një kopje të ligjit të kontestuar ose vendimit të miratuar nga Kuvendi, regjistrin dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën dhe autorizimin e personit që i përfaqëson ata para Gjykatës”.*

68. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës: (i) shënuan emrat e deputetëve me nënshkrime si dhe paraqitën autorizimin për personin që i përfaqëson para Gjykatës; (ii) specifikuan vendimin që kontestojnë dhe dorëzuan kopjen e tij; (iii) iu referuan dispozitave relevante kushtetuese për të cilat ata pretendojnë se Vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri; dhe (iv) paraqitën provat dhe dëshmitë e tyre në mbështetje të pretendimeve përkatëse. Andaj, Gjykata konsideron se kriteret e përcaktuara me nenin 42 të Ligjit dhe të specifikuara më tej me rregullin 74 të Rregullores së punës janë plotësuar.
69. Gjykata më tej vlerëson nëse kërkesa është paraqitur në afatin e përcaktuar prej “8 (tetë) ditësh nga data e miratimit”, ashtu siç përcaktohet në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Vendimi i kontestuar është miratuar më 30 qershor 2021, ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 7 korrik 2021. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa u parashtrua brenda afatit kohor të përcaktuar me Kushtetutë.
70. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës. Gjykata gjithashtu konsideron se kërkesa ngre çështje të rëndësishme kushtetuese lidhur me pavarësinë institucionale të Këshillit të Pavarur, si institucion i pavarur sipas Kushtetutës, i cili siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin civil. Për pasojë, kërkesa duhet të shpallet e pranueshme dhe të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

71. Gjykata fillimisht rithekson që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Vendimin [nr. 08-V-029] e 30 qershorit 2021 të Kuvendit, përmes të cilit, bazuar në Rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, janë shkarkuar kolektivisht pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur.
72. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi i kontestuar i Kuvendit në aspektin përmbajtësor dhe procedural është në kundërshtim me nenin 101 [Shërbimi Civil] dhe 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.
73. Në lidhje me kërkesën e tyre, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës, në thelb, lidhur me pretendimet e tyre kushtetuese i referohen: (i) nenit 101 të Kushtetutës, duke theksuar se i njëjti e vendos Këshillin e Pavarur në funksionin e një institucioni të pavarur, e që Kuvendi, Qeveria dhe organet tjera politike zhvishen nga kompetencat që të ndërhyjnë në ruajtjen e integritetit profesional dhe civil të shërbimit civil; (ii) nenit 142 të Kushtetutës, duke theksuar se i njëjti rregullon formën dhe mënyrat e themelimit të Agjencive të Pavarura, në esencë duke e kategorizuar Këshillin e Pavarur në këtë pjesë, gjithashtu duke theksuar se agjencitë ushtrojnë funksionet e tyre ligjore pa ndikim dhe në mënyrë të pavarur nga çdo udhëzim apo ndërhyrje e organeve tjera shtetërore, përfshirë organin që e ka themeluar.
74. Më tej, Gjykata rikujton se në elaborimin e shkeljeve të pretenduara kushtetuese si më lart, parashtruesit e kërkesës: (i) i referohen Ligjit për KPMSHCK-në duke theksuar se me këtë rast ka pasur shkelje të procedurës që është ndjekur për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur sepse të njëjtit janë shkarkuar në mënyrë kolektive edhe pse zgjedhën individualisht në pozitën e tyre; (ii) i referohen nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, duke theksuar se Vendimi për shkarkimin/ndërprerjen e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur është kundër-kushtetues sepse me rastin e shkarkimit nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet e këtij neni dhe se nuk ekziston asnjë fakt i paraqitur në rekomandim që pretendon se anëtarët e Këshillit të Pavarur e kanë shkelur ligjin; (iii) pohojnë se anëtarët e Këshillit dhe vetë Këshilli si organi i pavarur kushtetues i janë nënshtruar presionit dhe ndërhyrjeve nga ana e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike e që sipas parashtruesve të kërkesës dëshmon tendencën për të ndërhyrë në pavarësinë e këtij institucioni; dhe (iv) duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO171/18 e veçanërisht paragrafit 247 të tij, dhe paragrafit 3 të nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, theksojnë çështjen e imunitetit nga shkarkimi për vendimmarrje.
75. Marrë parasysh pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe rrethanat që ngërthen rasti, Gjykata thekson se është e rëndësishme që së pari të elaborohet statusi i Këshillit të Pavarur dhe pavarësia e tij si institucion bazuar në Kushtetutë, ligjet e aplikueshme dhe në Aktgjykimet e Gjykatës; si dhe kompetenca e Kuvendit për të mbikëqyrë punën e Këshillit të Pavarur, duke kaluar më pas në vlerësimin e

kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar për shkarkimit e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim do të shtjellojë parimet e përgjithshme lidhur me (i) aplikueshmërinë e nenit 142 të Kushtetutës; (ii) statusin dhe pavarësinë e Këshillit të Pavarur dhe anëtarëve të tij, bazuar në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës; për të vazhduar më pas me (iii) kompetencën e Kuvendit për mbikëqyrjen e Këshillit të Pavarur; dhe në fund do të aplikojë këto parime në (iv) vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar.

I. Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës

76. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesit e kërkesës, mes tjerash, i referohen nenit 142 të Kushtetutës, për të mbështetur argumentet e tyre, lidhur me cenimin e pavarësisë së Këshillit të Pavarur.
77. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton Aktgjykimin e saj KO171/18, në të cilin kishte vlerësuar kushtetutshmërinë e Ligjit për KPMSHCK-në, ligj ky i cili rregullon funksionet, kompetencat, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Pavarur (shih, rastin e Gjykatës KO171/18, me parashtrues *Avokati i Popullit*, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, Aktgjykim i 25 prillit 2019). Përmes këtij Aktgjykimi, Gjykata, ndër tjerash, theksoi se Kapitulli XII [Institucionet e Pavarura] i Kushtetutës rregullon në mënyrë të veçantë institucionet e pavarura si në vijim: (i) Avokatin e Popullit (nenet 132-135 të Kushtetutës); (ii) Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës (nenet 136-138 të Kushtetutës); (iii) Komisionin Qendror i Zgjedhjeve (neni 139 i Kushtetutës); (iv) Bankën Qendrore të Kosovës (neni 140 i Kushtetutës); dhe (v) Komisionin e Pavarur të Medieve (neni 141 i Kushtetutës). Po ashtu, neni 142 [Agjencitë e Pavarura] i Kushtetutës, në kuadër të të njëjtit kapitull, përcakton mundësinë e krijimit të Agjencive të Pavarura nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Sipas këtij neni, këto agjenci, (i) funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës; dhe (ii) secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligjin përkatës.
78. Përveç kësaj, Kushtetuta ka themeluar edhe disa institucione tjera, ndër të tjera, Gjykatën Kushtetuese në kapitullin VIII të saj, si dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil në nenin 101 të saj. Në Aktgjykimin e saj në rastin KO171/18, Gjykata konstatoi që Këshilli i Pavarur nuk mund të kategorizohet si institucion i pavarur kushtetues sipas Kapitullit XII të Kushtetutës dhe as si agjenci e pavarur në bazë të nenit 142 të Kushtetutës, për shkak se (i) Kushtetuta, në mënyrë shprehimore, i ka përcaktuar në Kapitullin XII të saj, institucionet e pavarura kushtetuese, duke përcaktuar edhe rolin dhe statusin e tyre; si dhe (ii) në

Kapitullin XII, neni 142 i Kushtetutës, ka krijuar bazën kushtetuese për themelimin e agjencive të pavarura, duke përcaktuar se janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse e të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre (shih, rastin KO171/18, cituar më lartë, paragrafët 155-159).

79. Gjykata vëren se përderisa, themelimi i agjencive të pavarura në bazë të nenit 142 të Kushtetutës, është kompetencë e Kuvendit, dhe i cili përmes ligjeve përkatëse rregullon edhe themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre, Kuvendi nuk ka të njëjtën kompetencë përkitazi me institucionet e themeluara përmes dispozitave kushtetuese, duke përfshirë Këshillin e Pavarur, sepse themelimi, funksionimi dhe kompetencat e tij, për aq sa janë të rregulluara me Kushtetutë, nuk mund të ndryshohen nga Kuvendi, përpos përmes amendamenteve kushtetuese.
80. Gjykata marrë parasysh të lartcekurat, rithekson se për dallim nga Agjencitë e Pavarura dhe të cilat bazuar në nenin 142 të Kushtetutës, themelohen nga Kuvendi, Këshilli i Pavarur është institucion i cili është i themeluar përmes nenit 101 të Kushtetutës, dhe si i tillë pavarësia institucionale, e cila i është atribuar, tejkalon atë të garantuar për Agjencitë e Pavarura përmes nenit 142 të Kushtetutës. Për pasojë, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës në kuadër të fushëveprimit të nenit 101 të Kushtetutës.

II. Sa i përket statusit dhe pavarësisë së Këshillit të Pavarur dhe anëtarëve të tij, bazuar në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës

81. Gjykata rikujton se paragrafi 2 i nenit 101 përcakton se “Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës.”
82. Duke u bazuar në këtë normë kushtetuese, Gjykata fillimisht do të trajtojë pavarësinë e Këshillit të Pavarur bazuar në (i) parimet e përgjithshme në lidhje me Këshillin sipas Kushtetutës, Ligjit për KPMSHCK-në dhe praktikës së Gjykatës; dhe (ii) pavarësinë individuale të anëtarëve të Këshillit të Pavarur.
- (i) *Parimet e përgjithshme në lidhje me pavarësinë e Këshillit sipas Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës*
83. Gjykata fillimisht thekson që Këshilli i Pavarur është institucion i themeluar me Kushtetutë. Kjo e fundit i ka atribuar Këshillit të Pavarur (i) cilësimin e institucionit “të pavarur” në lidhje me (ii) ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, përkatësisht, “sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”. Më saktësisht, paragrafi 2 i nenit 101 të Kushtetutës, (i) përcakton saktë emërtimin e Këshillit Mbikëqyrës si i “pavarur”; dhe (ii) këtë “pavarësi” ia ka atribuar me qëllim të “sigurimit të respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”. Për pasojë, qëllimi i dispozitës

përkatëse kushtetuese reflekton pavarësinë institucionale të Këshillit të Pavarur me qëllim të ushtrimit të funksionit të tij për “sigurimin e respektimit të parimeve dhe rregullave që rregullojnë shërbimin civil”. Ushtrimi i pavarur i këtij funksioni sigurohet përmes vendimmarrjes së pavarur të anëtarëve të vet Këshillit të Pavarur.

84. Gjykata gjithashtu vëren se e njëjta pavarësi i është përcaktuar Këshillit të Pavarur përmes Ligjit për KPMSHCK-në. Neni 6 (Funksionet e Këshillit) i Ligjit për KPMSHCK-në, ndër tjerash, përcakton se: “Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil; 1.3. monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë.” Rrjedhimisht, funksioni i pavarur i Këshillit të Pavarur përkitazi me “sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil” realizohet përmes kompetencës së tij, përkatësisht anëtarëve të tij, për marrjen e vendimeve lidhur me ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.
85. Në këtë kontekst, dhe përmes një numër vendimesh të saj, Gjykata ka trajtuar natyrën e vendimeve të Këshillit të Pavarur, duke theksuar përmes praktikës së saj gjyqësore, duke e përfshirë rastin e saj KI33/16, që Këshilli i Pavarur gëzon prerogativat e një gjykate në kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Përmes kësaj praktikë gjyqësore, Gjykata ka theksuar se “gjykata” kategorizohet në kuptimin substancial të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë vendosja e çështjeve brenda kompetencave të saj në bazë të rregullave të së drejtës dhe pas procedurave të kryera në mënyrë të paraparë [...], duke përcaktuar se vendimet e Këshillit të Pavarur janë “përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme” dhe se Këshilli i Pavarur nga plotëson kriteret e një “tribunali” sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, pasi, mes tjerash,(a) është i pavarur prej ekzekutivit; dhe (b) ka juridiksion të plotë për të vendosur për çështjet që vendosen para tij ashtu siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës KI33/16, *Minire Zeka*, Aktgjykim i 6 korrikut 2016, paragrafi 59; ndërsa në lidhje me pavarësinë e një “tribunali të pavarur”, shih, rastin KO12/17, parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 9 majit 2017, paragrafi 75; si dhe rastin KO171/18, cituar më lart, paragrafi 163).
86. Për më shumë, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar që Këshilli i Pavarur kualifikohet si institucion “kuazi gjyqësor”, përkatësisht si tribunal përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil (emërtimi “tribunal” gjen përdorim më të gjerë në diskursin e GJEDNJ-së). Rrjedhimisht, Këshilli i Pavarur gëzon prerogativat e një “gjykate” pikërisht për shkak të pavarësisë nga ekzekutivi dhe legjislativi dhe kualifikohet si institucion që ka juridiksion të plotë që të nxjerr vendime të detyrueshme, në lidhje me konfliktet në mes të shërbyesve civil ose kandidatëve për shërbyes civil në njërën anë, dhe institucioneve që kanë të

punësuar nëpunësit civil, në anën tjetër (shih, rastin e Gjykatës KO171/18, cituar më lart, paragrafi 165).

87. Sigurisht që ligjshmëria e vendimeve të Këshillit të Pavarur i nënshtrohet më tej kontrollit të pushtetit gjyqësor, përmes inicimit të konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda kushteve dhe afateve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Konfliktin Administrativ, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 22 (Inicimi i konfliktit administrativ) të Ligjit për KPMSHCK-në. Rrjedhimisht, kontrolli, përkatësisht vlerësimi i ligjshmërisë së vendimeve të Këshillit të Pavarur, është kompetencë e pushtetit gjyqësor.
88. Marrë parasysh të lartcekurat, përkatësisht dispozitat kushtetuese, ligjore dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, përkitazi me pavarësinë e Këshillit të Pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij dhe natyrën e vendimeve të nxjerra nga i njëjti, Gjykata në vijim do të shtjellojë parimet që ndërlidhen me pavarësinë e anëtarëve të Këshillit të Pavarur.

(ii) Pavarësia individuale e anëtarëve të Këshillit të Pavarur

89. Gjykata rithekson se Këshilli i Pavarur është institucion i themeluar me Kushtetutë dhe të cilit kjo e fundit, i ka përcaktuar (i) cilësimin e institucionit “*të pavarur*” në lidhje me (ii) ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, përkatësisht, “*sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil*”. Sigurimi i respektimit të këtyre rregullave dhe parimeve realizohet përmes vendimmarrjes së anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Si rezultat i këtij funksioni që Kushtetuta ia ka atribuuar Këshillit të Pavarur, përmes praktikës së saj gjyqësore, Gjykata ka vënë theks në (i) cilësimin e Këshillit si institucion “*kuazi gjyqësor*”, përkatësisht si tribunal përkitazi me zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil; dhe (ii) faktin që vendimet e Këshillit të Pavarur janë “*përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme*”. Sigurisht që pavarësia kushtetuese e Këshillit të Pavarur përkitazi me funksionin e tij kushtetues në “*sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil*”, ngërthen edhe pavarësinë e anëtarëve të Këshillit të Pavarur përkitazi me vendimmarrjen e tyre.
90. Në kontekst të kësaj pavarësie, Kuvendi, përmes miratimit të Ligjit për KPMSHCK-në, u ka siguruar anëtarëve të Këshillit të Pavarur imunitet përkitazi me vendimmarrjen e tyre. Më saktësisht, paragrafi 3 i nenit 11 (Mandati i anëtarëve të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, përcakton që “*Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi*”. Kjo dispozitë është vlerësuar edhe nga Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KO171/18, dhe pas shqyrtimit të praktikave përkatëse gjyqësore por edhe raporteve relevante të Komisionit të Venecias, është vlerësuar “*në pajtueshmëri me Kushtetutën*”.

91. Sigurisht që, bazuar në po të njëjtin Aktgjykim, imuniteti funksional, që u garantohet anëtarëve të Këshillit të Pavarur sipas Ligjit të KPMSHCK-së, është i limituar dhe nuk përfshin veprimet jashtë fushëveprimit të tyre si anëtarë të Këshillit të Pavarur, duke përfshirë nëse ata akuzohen për vepra penale, që nuk ndërlidhen thjesht me faktin që ata kanë ushtruar funksionet e tyre që ndërlidhen me pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre si anëtarë të Këshillit të Pavarur. Ata gjithashtu nuk kanë imunitet as nga arrestimi (shih, rastin e Gjykatës KO171/18, cituar më lart, paragrafi 244). Gjykata ka vlerësuar se qëllimi i imunitetit, të cilin anëtarët e Këshillit të Pavarur e gëzojnë, është që të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre, me theks në vendimmarrje (shih rastin e Gjykatës KO171/18, cituar më lart, paragrafi 247).
92. Për më tepër, pavarësia individuale të anëtarëve të Këshillit të Pavarur në kuptim të vendimmarrjes përfshin edhe të shprehurit e kësaj pavarësie jo vetëm përballë ndikimeve të jashtme që mund të kenë anëtarët e Këshillit të Pavarur, por edhe përballë ndikimeve nga organi, i cili i ka emëruar në pozitat përkatëse, përkatësisht Kuvendi. Gjykata rikujton që një pavarësi të tillë, Kushtetuta iu ka atribuuar edhe agjencive të pavarura, të cilat në fakt themelohen nga vet Kuvendi përmes nenit 142 të Kushtetutës. Gjykata thekson se kjo pavarësi, ngërthen qëllimin që anëtarët e agjencive përkatëse të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre kushtetuese dhe ligjore.
93. Gjykata, më tej, gjithashtu vëren se Ligji për KPMSHCK-në, përkatësisht neni 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) i tij, përcakton rastet e ndërprerjes së mandatit të anëtarit të Këshillit të Pavarur nga Kuvendi sipas propozimit nga Komisioni përkatës i Kuvendit për administratë publike apo shumicës e anëtarëve të vet Këshillit, duke u kufizuar në shkaqet vijuese: (i) për shkelje të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në; (ii) kur kryen veprimtari, që krijon konflikt të interesit dhe përkundër paralajmërimit nga organi kompetent nuk e eliminon konfliktin e interesit sipas ligjit përkatës; (iii) në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij; dhe (iv) në rast të mungesës pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsyet që nuk parashihen me ligj.
94. Megjithatë, marrë parasysh formulimin e (i) paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës; (ii) praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të sqaruar më lart; dhe (iii) leximin e përbashkët të nenit 15 dhe paragrafit 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në, përkatësisht mundësinë e ndërprerjes së mandatit të anëtarit të Këshillit të Pavarur nga Kuvendi dhe imunitetin, të cilin ua ka përcaktuar i njëjti përkitazi me shkarkimin lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit të Pavarur, Gjykata thekson se anëtari i Këshillit nuk mund të shkarkohet për arsye të vendimmarrjes, përkatësisht mënyrës së votimit gjatë shqyrtimit të rasteve konkrete. Ligjshmëria e vendimmarrjes së tillë në fakt dhe siç është sqaruar më lart, i takon pushtetit gjyqësor, përmes procedurës së konfliktit administrativ siç është përcaktuar në nenin 22 të Ligjit për KPMSHCK-në.

III. Sa i përket kompetencës së Kuvendit për mbikëqyrjen e Këshillit të Pavarur

95. Kompetenca e Kuvendit për të mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit është e përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës. Në rastin e Këshillit të Pavarur, kjo kompetencë e Kuvendit është më tej e detajuar përmes Ligjit për KPMSHCK-në. Më saktësisht, përmes (i) nenit 4 (Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës) dhe nenit 28 (Raporti vjetor i Këshillit), sipas të cilëve përcaktohet detyrimi i Këshillit të Pavarur që për punën e tij t'i raportojë Kuvendit, së paku njëherë në vit, dhe sa herë që i kërkohet nga Kuvendi dhe procedura përkatëse; (ii) paragrafit 1 të nenit 8 (Përbërja e Këshillit) dhe nenit 10 (Procedura për emërimin e anëtarëve të Këshillit), të cilët përcaktojnë kompetencën e Kuvendit për të emëruar anëtarët e Këshillit të Pavarur dhe procedurën përkatëse; (iii) nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit), i cili përcakton bazat ligjore mbi të cilat mund të ndërprehet mandati i një anëtarit të Këshillit të Pavarur dhe procedura që duhet ndjekur; dhe (iv) nenit 27 (Financimi i Këshillit), i cili përcakton pavarësinë buxhetore të Këshillit të Pavarur, por edhe detyrimin e tij që për kontributet e pranuar nga donatorët, ta njoftojë Kuvendin. Për më tepër, Gjykata thekson që vet Kuvendi përmes Ligjit për KPMSHCK-në, përkatësisht neneve 23 (Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit) dhe 24 (Sanksionet administrative për moszbatimin e vendimit të Këshillit) të tij, ka vënë theks në rëndësinë e zbatimit të vendimeve të Këshillit të Pavarur, duke përcaktuar edhe procedurën që duhet ndjekur në rast se një i tillë nuk zbatohet, sanksionet përkatëse si dhe detyrimin e Këshillit të Pavarur që Kuvendi të njoftohet në raste të tilla.
96. Nisur nga këto norma kushtetuese dhe ligjore, Gjykata fillimisht thekson që është i padiskutueshëm autorizimi i Kuvendit që bazuar në paragrafin 9 të neni 65 të Kushtetutës, të mbikëqyrë Këshillin e Pavarur. Mekanizmat e kësaj mbikëqyrjeje janë më tej të përcaktuar në Ligjin për KPMSHCK-në dhe e njëjta materializohet përmes së trupave parlamentare siç janë komisionet e përhershme, komisionet funksionale dhe komisionet *ad hoc*, të cilat në bazë të paragrafit 1 të nenit 77 [Komisionet] të Kushtetutës, Kuvendi i emëron, e që në rastin konkret, rezulton të jetë Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike.
97. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu rikujton se edhe Komisioni i Venecias ka trajtuar rolin mbikëqyrës të Kuvendit, e veçanërisht punën e Komisioneve dhe në Opinionin e saj, ka theksuar se komisionet e përhershme, duhet të ushtrojnë kontroll efikas në fushën e tyre të kompetencës, i cili nuk duhet të kufizohet në shqyrtimin e raporteve të paraqitura nga organet dhe zyrtarët e shtetit, por duhet gjithashtu të përfshijë një kontroll më aktiv të veprimeve të ekzekutivit dhe agjencive të pavarura (shih, Opinionin nr. 845/2016 të Komisionit të Venecias me titull "*Parametrat në Marrëdhënien në mes të Shumicës Parlamentare dhe Opozitës në Demokraci*", CDL-AD (2019) 015 i 24 qershorit 2019, paragrafi 92).

98. Prandaj, Gjykata vëren se kompetenca e mbikëqyrjes së Këshillit të Pavarur nga ana e Kuvendit nuk kufizohet vetëm në raportim të thjeshtë periodik, por i njëjti mund edhe të vendosë për shkarkimin e anëtarëve të caktuar të Këshillit të Pavarur, bazuar në nenin 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në, i cili përcakton që propozimin për shkarkim të anëtarit të Këshillit të Pavarur kanë të drejtë ta bëjnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Pavarur ose Komisioni përkatës i Kuvendit për Administratë Publike, dhe përcakton që Kuvendi me shumicë të votave mund të shkarkojë anëtarin e Këshillit të Pavarur për shkak të arsyeve si në vijim: (i) për shkelje të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në, siç është përcaktuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 15; (ii) kur kryen veprimtari, që krijon konflikt të interesit dhe përkundër paralajmërimit nga organi kompetent nuk e eliminon konfliktin e interesit sipas ligjit përkatës, siç është përcaktuar në pikën 1.2 të paragrafit 1 të nenit 15; (iii) në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij, siç është përcaktuar në pikën 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15; dhe (iv) mungon pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsyet që nuk parashihen me ligj, siç është përcaktuar në pikën 1.4 të paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në.
99. Megjithatë, ushtrimi i kompetencës së mbikëqyrjes nga Kuvendi, i përcaktuar përmes paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës, është i kufizuar nga raporti përkatës me paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës në kuptim të pavarësisë së Këshillit të Pavarur në ushtrimin e funksionit të tij kushtetues, ndërsa ushtrimi i kompetencës së shkarkimit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur nga Kuvendi, kontestues në rrethanat e rastit konkret, është i kufizuar edhe nga raporti në mes (i) paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës dhe Ligjit për KPMSHCK-në; dhe (ii) nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në, që përcakton mundësinë e ndërprerjes së mandatit dhe paragrafit 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në, që përcakton imunitetin nga shkarkimi përkitazi me vendimmarrjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur.
100. Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, Rekomandimi i Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike për shkarkim të anëtarëve të Këshillit të Pavarur dhe për pasojë edhe Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e të njëjtëve, bazohet në pikat 1.1. dhe 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 (Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit) të Ligjit për KPMSHCK-në. Përderisa, Ligji për KPMSHCK-në përcakton kompetencën e Kuvendit për të ndërprerë mandatin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur në rastet dhe nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj, Gjykata, bazuar në parimet e shtjelluar më lart, në vijim, duhet të vlerësojë nëse mënyra e ushtrimit të një kompetencë të tillë të Kuvendit, mund të ketë rezultuar (i) në tejkalimin e autorizimeve të përcaktuara përmes paragrafit 9 të nenit 65 të Kushtetutës; dhe (ii) cenimin e garancioneve, të përcaktuara përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës.

Aplikimi i parimeve të lartpërmendura në rastin konkret

101. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash, dhe në kontekst të Vendimit të kontestuar, theksojnë se bazuar në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës, Këshilli është organ i pavarur dhe i vetmi që ka kompetencë për

ruajtjen e integritetit profesional të shërbimit civil dhe se përmes Vendimit të kontestuar, Kuvendi ka ndërhyrë në mënyrë kundër-kushtetuese në pavarësinë e funksionit të Këshillit të Pavarur. Për më tepër, ata gjithashtu theksojnë që bazuar në arsyetimin e Vendimit të kontestuar, nuk ekziston asnjë fakt i paraqitur: (i) që dëshmon se anëtarët e Këshillit të Pavarur kanë shkelur Ligjin për KPMSHCK-në; (ii) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë kryer veprimtari, që krijon konflikt të interesit; (iii) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë kryer detyrat në papajtueshmëri me funksionin e tyre; ose (iv) që dëshmon se anëtarët e shkarkuar të Këshillit të Pavarur kanë munguar pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë për arsye që nuk parashihen me ligj, siç përcaktohet me nenin 15 të Ligjit për KPMSHCK-në. Në anën tjetër, Gjykata rikujton argumentet e deputetes Xhelili-Kica, e cila thekson se parashtuesit e kërkesës nuk e kanë të qartë procesin ligjvënës dhe funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, ngase për t'u vlerësuar një akt i Kuvendit në aspektin kushtetues do të duhej që Kushtetuta të përcaktojë shprehimisht të paktën se cila është procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Pavarur, madje edhe procedurën e shkarkimit.

102. Në kontekst të këtyre pretendimeve, Gjykata tashmë ka theksuar që (i) pavarësia e Këshillit të Pavarur është e përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës, në kuptim të funksionit të tij kushtetues për të *“siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”*; (ii) funksioni kushtetues i *“sigurimit të respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”*, realizohet përmes vendimmarrjes së pavarur të anëtarëve të Këshillit të Pavarur, përkatësisht pavarësisë së funksionit të tyre individual; (iii) bazuar në praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës, Këshilli i Pavarur cilësohet si institucion *“kuazi gjyqësor” dhe se vendimet e tij janë “përfundimtare, të detyrueshme dhe të ekzekutueshme”*, cilësim ky të cilin ia ka atribuuar edhe vet Kuvendi, ndër tjerash, përmes Ligjit për KPMSHCK-në, duke përfshirë nenet 23 dhe 24 të tij; (iv) Kuvendi bazuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës dhe bazuar në dispozitat e Ligjit për KPMSHCK-në, ka kompetencën e mbikëqyrjes së Këshillit të Pavarur, përmes mekanizmave të përcaktuara në ligjin e lartcekur, duke përfshirë edhe kompetencën e ndërprerjes së mandatit të anëtarëve të Këshillit të Pavarur; dhe (v) kompetenca e Kuvendit për mbikëqyrjen e Këshillit të Pavarur dhe anëtarëve të tij, duhet të ushtrohet në përputhje me garancitë institucionale të Këshillit të Pavarur të përcaktuara përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të Ligjit për KPMSHCK-në.
103. Në vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, ushtrimi i kompetencës së mbikëqyrjes së Kuvendit, siç është përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës, ka tejkaluar autorizimet përkatëse në cenim të garancive institucionale të Këshillit të Pavarur, siç janë përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se përmes Vendimit të kontestuar, pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur janë shkarkuar në mënyrë kolektive. Rekomandimi përkatës i Komisionit për Administratë Publike, i cili i ka paraprirë Vendimit të kontestuar, kishte arsyetuar si në vijim:

[...] Rekomandimi për inicimin për shkarkimin e anëtareve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, bëhet sipas nenit 15, paragrafi 1, pika 1 dhe 3, si në vijim:

- 1.1 për shkelje të dispozitave të ligjit për KPMSHCK-në;
1.3 në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij;

Komisioni në mbledhjen e mbajtur me 01.06.2021, ka shqyrtuar raportin vjetor të punës së KPMSHCK-së, dhe i ka rekomanduar Kuvendit mosmiratimin e [tij]. Në mbledhjen e mbajtur me 15.06.2021, është diskutuar lidhur me shkeljet e anëtarëve të [Këshillit]. Me këtë rast, është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes [...].

104. Gjykata rikujton që bazuar në këtë Rekomandim, Kuvendi ka nxjerrë Vendimin për shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur. Ky Vendim i Kuvendit, përmban dy pika. E para, përcakton që “shkarkohen pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës së Shërbimit Civil të Kosovës”, duke listuar pesë (5) emrat përkatës. Ndërsa, e dyta, thjeshtë përcakton që “Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit”.
105. Duke marrë parasysh që Vendimi i kontestuar i Kuvendit nuk përmban asnjë sqarim shtesë përkitazi me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur, Gjykata duke u referuar në përmbajtjen e Rekomandimit të Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, vëren se anëtarët e Këshillit të Pavarur janë shkarkuar në mënyrë kolektive, nën arsyetimin se (i) kanë bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për KPMSHCK-në, siç është përcaktuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 15 të tij; dhe (ii) kanë kryer detyra në papajtueshmëri me funksionin e tyre, siç është përcaktuar në pikën 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 të tij. Rekomandimi përkatës për më tepër thekson se “është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes.”
106. Në vijim, Gjykata do të analizojë Vendimin e kontestuar të Kuvendit për shkarkimin kolektiv të pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur, duke u referuar në bazat ligjore mbi të cilat është nxjerrë, duke filluar me (i) pikën 1.3 të paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në; për të vazhduar me (ii) pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në.
107. Lidhur me arsyetimin e Kuvendit, përkatësisht arsyetimin e ngërthyer në Rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratën Publike, Gjykata vëren se pika 1.3 e paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në përcakton mundësinë e ndërprerjes së mandatit “në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri me funksionin e tij”. Rastet e papajtueshmërisë së funksionit të anëtarit të Këshillit të Pavarur janë shprehimisht të përcaktuara në Ligjin për KPMSHCK-në, përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 11 të tij, dhe i cili përcakton që “anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitete politike”. Rekomandimi,

përkatësisht, Vendimi i kontestuar i Kuvendit, nuk përmban (i) asnjë referencë në paragrafin 2 të nenit 11 të Ligjit për KMP SHCK-në; dhe (ii) asnjë fakt apo arsyetim se si pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur mund të kenë ushtruar detyrat e anëtarit të Këshillit të Pavarur në papajtueshmëri me funksionin e tyre, përkatësisht mund të kenë ushtruar ndonjë funksion tjetër shtetëror, mund të kenë ushtruar funksionin e një anëtari të një partie politike ose mund të kenë marrë pjesë në aktivitete politike.

108. Ndërsa, lidhur me arsyetimin e Kuvendit, përkatësisht arsyetimin e ngërthyer në Rekomandimin e Komisionit të Kuvendit për Administratën Publike, Gjykata vëren se pika 1.1 e paragrafit 1 të nenit 15 të Ligjit për KPMSHCK-në përcakton mundësinë e ndërprerjes së mandatit *“për shkelje të dispozitave të këtij ligji”*. Rekomandimi, përkatësisht Vendimi i kontestuar, nuk përmban asnjë fakt e arsyetim se si pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur mund të kenë të ushtruar detyrat e anëtarit të Këshillit të Pavarur *“në shkelje të dispozitave të këtij ligji”*.
109. Gjykata vëren megjithatë që Rekomandimi i Komisionit të Kuvendit për Administratën Publike që ka rezultuar në Vendimin e kontestuar të Kuvendit, thekson se *“është vlerësuar se Këshilli ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Ligjit për KPMSHCK, për arsye se nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes.”* Në këtë kontekst, Gjykata i referohet përmbajtjes së nenit 12 të Ligjit për KPMSHCK-në, i cili përcakton detyrat e anëtarëve të Këshillit të Pavarur, si në vijim: (i) që të ushtrojnë funksionin e anëtarit në mënyrë të paanshme dhe të vendosin në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin; (ii) të ruajnë autoritetin dhe imazhin e Këshillit të Pavarur; dhe që (iii) secili anëtar ka për detyrë të marr pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Këshillit të Pavarur, si dhe të kryejë punët e tjera të caktuara me ligj, me rregulloren e punës dhe aktet tjera nënligjore të Këshillit të Pavarur. Gjykata vëren se Rekomandimi i lartcekur bazuar në të cilin është nxjerrë Vendimi i kontestuar i Kuvendit, nuk i referohet asnjë fakti e arsyetimi në mbështetje të shkeljes së pretenduar të kësaj dispozite nga pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur kolektivisht.
110. Për më tepër, Gjykata thekson se përmbajtja e nenit 12 të Ligjit për KPMSHCK-në, thjeshtë përcakton detyrimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur që (i) të ushtrojnë funksionin e anëtarit në mënyrë të paanshme dhe të vendosin në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin duke e ruajtur autoritetin dhe imazhin e Këshillit; (ii) secili anëtar ka për detyrë të marr pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Këshillit të Pavarur; dhe (iii) secili anëtar ka për detyrë të kryejë punët e tjera të caktuara me ligj, me rregulloren e punës dhe aktet tjera nënligjore të Këshillit të Pavarur. I vetmi arsyetim i Rekomandimit që ka rezultuar në Vendimin e kontestuar të Kuvendit, në kuptim të *“shkeljes së dispozitave të këtij ligji”*, siç është përcaktuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 15, është se pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur kolektivisht *“nuk kanë zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes.”* Duke marrë parasysh që Rekomandimi/Vendimi i kontestuar i Kuvendit nuk përmban asnjë fakt e arsyetim shtesë përkitazi me shkeljen e dispozitave të ligjit, përpos referimit në *“vendimmarrjen”* e anëtarëve të Këshillit të Pavarur, përkatësisht pretendimin për moszbatimin e *“ligjeve të aplikueshme*

gjatë vendimmarrjes”, rezulton se pesë (5) anëtarë të Këshillit të Pavarur janë shkarkuar përkitazi me vendimmarrjen e tyre në ushtrimin e funksionit për të *“siguruar respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”*, siç është përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës.

111. Përtej përmbajtjes së vet Rekomandimit/Vendimit të kontestuar, sipas të cilit, anëtarët e Këshillit të Pavarur janë shkarkuar për *“vendimmarrje”*, Gjykata gjithashtu rikujton se veprimet e Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, përmes pyetjeve specifike në raste konkrete dhe kërkimit të dosjeve, të cilat i kanë paraprirë Vendimit të kontestuar, konsistojnë në një kontroll të punës së Këshillit të Pavarur në rolin e tyre si vendimmarrës në rastet e parashtruara pranë tij.
112. Më specifikisht, Rekomandimi i lartcekur i Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike për shkarkimin të anëtarëve të Këshillit të Pavarur ka vijuar pas (i) mos miratimit të raportit vjetor të Këshillit të Pavarur; (ii) pyetjeve të parashtruara nga deputetët në seancën e Komisionit Parlamentar për Administratë Publike lidhur me performancën e Këshillit; dhe (iii) komunikimit përmes Sekretarisë së Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike, duke kërkuar informata shtesë dhe qasje në dosje specifike të rasteve të Këshillit të Pavarur. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se Komisioni i Kuvendit për Administratë Publike kishte parashtruar pyetje specifike përkitazi me vendimmarrjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur dhe specifikisht lidhur me: (i) të gjitha lëndët që kanë qenë në pritje para se Këshilli të Pavarur të vendoste për lëndën që ishte diskutuar në Komision (rasti i N.K.-së), përfshirë por pa u kufizuar në evidentimin e numrit të lëndëve paraprake para se të vendoset për këtë rast; dhe (ii) numrin e saktë të të gjitha lëndëve në pritje, data e saktë e parashtrimit të secilës ankese/kërkesë/parashtrësë që ka qenë në pritje dhe është dorëzuar para lëndës së N.K.-së, e që megjithatë nuk është trajtuar para kësaj lënde. Po ashtu, ky Komision kërkoi edhe informatat si në vijim: (i) a janë trajtuar të gjitha rastet që u evidentuan si në pritje në pyetjen paraprake, brenda afatit dyzet e pesë (45) ditësh, dhe të konfirmohet në qoftë se të gjitha këtyre rasteve nuk ka pasur nevojë t'i jepet kohë shtesë për trajtim, por ka mjaftuar afati në fjalë apo ajo që ka mbetur nga ky afat me rastin e bartjes; dhe me rastin e dërgimit të këtij sqarimi, Zyra Koordinuese e Komisionit kërkoi edhe që (ii) t'i dërgohen edhe datat e vendimmarrjes për rastet që u identifikuan si në pritje në pyetjen paraprake; dhe (iii) të bashkëlidhin dosjen e plotë të rastit të N.K.-së.
113. Në kontekst të të lartcekurave, Gjykata rikujton parimet e përgjithshme në kuptim të paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës dhe se bazuar në po të njëjtin, Këshilli i Pavarur është organ i pavarur, i cili duhet të sigurojë respektimin e rregullave dhe parimeve të shërbimit civil, respektimin e të cilave e bën përmes vendimmarrjes në rastet e parashtruara pranë tij, dhe e cila nënkupton pavarësinë individuale të anëtarëve të Këshillit të Pavarur në shqyrtimin e rasteve konkrete.
114. Për më tepër Gjykata, rikujton që (i) anëtarët e Këshillit të Pavarur gëzojnë pavarësi në vendimmarrjen e tyre në *“sigurimin respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”*, siç përcakton paragrafit 2 i nenit 101 të Kushtetutës;

(ii) kjo pavarësi është me tej e përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës në rastin KO171/18 dhe dispozitave ligjore, përkatësisht paragrafin 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në, i cili anëtarëve të Këshillit të Pavarur u atribuon imunitet lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit të Pavarur, nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi, i cili ua mundëson që të jenë të lirë të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi dhe pa frikën e pasojave për kryerjen e funksioneve të tyre në lidhje me *“pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre”*; (iii) përderisa Kuvendi ka kompetencë kushtetuese të mbikëqyrë Këshillin e Pavarur, duke përfshirë mundësinë e ndërprerjes së mandatit të anëtarëve të tij në rastet e përcaktuara në Ligjin për KPMSHCK-në, anëtarët e Këshillit të Pavarur nuk mund të shkarkohen vetëm për vendimmarrje sepse përkitazi me të njëjtën kanë imunitet nga shkarkimi, siç është përcaktuar në vet ligjin që e ka miratuar Kuvendi. Për më tepër që, bazuar në po të njëjtin ligj, ligjshmëria e vendimeve të Këshillit të Pavarur i nënshtrohet kontrollit të pushtetit gjyqësor dhe jo atij legjislativ.

115. Gjykata duke u bazuar në pavarësinë e Këshillit të Pavarur, natyrën e vendimeve që Këshilli i Pavarur nxjerr dhe në imunitetin funksional që anëtarët e Këshillit të Pavarur gëzojnë, konsideron se të njëjtit nuk mund të thirren në përgjegjësi për mënyrën e votimit apo vendimet e marra gjatë punës së tyre, sepse kjo do cenonte pavarësinë e tyre në ushtrimin e kompetencave si anëtarë të Këshillit të Pavarur, siç garantohet me parimet e mishëruara në paragrafin 2 të nenit 101 të Kushtetutës.
116. Gjykata rikujton se një anëtar i Këshillit të Pavarur, Kuvendi nuk mund t’ia kontrollojë arsyeshmërinë e vendimmarrjes meqenëse ato janë të mbrojtura me parimin e pavarësisë së vendimmarrjes së Këshillit të Pavarur, vendimmarrje kjo e ndërlidhur me *“sigurimin e respektimit të parimeve dhe rregullave të shërbimit civil”* sipas paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës, dhe e mbrojtur përmes imunitetit nga shkarkimi sipas paragrafit 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në.
117. Është detyrë e Kuvendit të mbikëqyrë, por, gjithashtu të ruajë pavarësinë e Këshillit të Pavarur, ashtu siç vetë e ka përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligjin për KPMSHCK-në. Kjo nënkupton, ndër tjerash, jo vetëm detyrën e përzgjedhjes së anëtarëve përmes një procesi të hapur, transparent dhe të bazuar në meritokraci, por edhe ndërprerjen eventuale të mandatit përkatës në baza individuale, duke argumentuar saktësisht faktet e arsyet për një propozim të tillë, bazuar në ato rrethanat për të cilat ligji lejon ndërprerjen e mandatit, dhe jo pritjeve të caktuara apo ndërhyrjeve të ligjvënësit për vendimet që anëtar i Këshillit të Pavarur ka marrë apo duhej të merrte. Gjykata rithekson se vendimmarrja e anëtarëve të Këshillit të Pavarur në raste konkrete mund të sfidohet nga pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit të Pavarur nuk është i ligjshëm, duke iniciuar konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Konfliktin Administrativ siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 22 të Ligjit për KPMSHCK-në.
118. Prandaj, Gjykata konstaton se Kuvendi duke shkarkuar anëtarët e Këshillit të Pavarur në bazë të paragrafit 1, pikave 1.1. dhe 1.3. të nenit 15 të Ligjit për

KPMSHCK-në, pa përfshirjen në Rekomandimin e Komisionit përkatës dhe Vendimin e kontestuar të Kuvendit, të asnjë fakti e të bazuar në ligj, përkitazi me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur në mënyrë kolektive, por vetëm me arsyetimin se Këshilli i Pavarur “*nuk ka zbatuar ligjet e aplikueshme gjatë vendimmarrjes*”, përkatësisht për shkak të vendimmarrjes së tyre në raste konkrete, për të cilën anëtarët e Këshillit të Pavarur gëzojnë imunitet nga shkarkimi, siç përcaktohet me paragrafin 3 të nenit 11 të Ligjit për KPMSHCK-në dhe e cila vendimmarrje, për më tepër, i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë nga pushteti gjyqësor në procedurën e konfliktit administrativ, siç është përcaktuar në nenin 22 të Ligjit për KPMSHCK-në, ka tejkalluar kufijtë e kompetencës së mbikëqyrjes së punës së institucioneve publike, të përcaktuar me paragrafin 9 të nenit 65 të Kushtetutës në cenim të garancive përkitazi me pavarësinë e Këshillit të Pavarur në ushtrimin e funksionit të tij, të përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 101 të Kushtetutës.

119. Për pasojë dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se Vendimi [nr. 08/V-029] i Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se Vendimi [Nr.07-V-063] i Kuvendit për zgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur, i 8 tetorit 2020, mbetet në fuqi.

Kërkesa për masë të përkohshme

120. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të pranojë nenin 43 të Ligjit, duke iu referuar kështu efektit pezullues *ex-lege* të zbatimit të ligjit apo vendimit të Kuvendit. Parashtruesit e kërkesës, në këtë kontekst, (i) kërkojnë nga Gjykata të informojë palët e përfshira që Vendimi i kontestuar pezullohet *ex-lege* dhe nuk dërgohet për zbatim deri në vendimin final të Gjykatës; dhe (ii) vlerësojnë se nuk është e nevojshme të kërkojnë shprehimisht pezullimin e zbatimit të aktit, përderisa i njëjti sipas ligjit do të duhej të nënshtrohej efektit pezullues në zbatim, meqë është kontestuar pranë kësaj Gjykate, në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
121. Më 21 tetor 2021, Gjykata vendosi sipas detyrës zyrtare masën e përkohshme deri më 15 dhjetor 2021, duke arsyetuar se e njëjta përbën interes publik, duke pezulluar kështu menjëherë Vendimin e kontestuar, dhe duke përcaktuar që Kuvendi duhet të përmbahet nga çdo veprim lidhur me çështjen e zgjedhjes së anëtarëve të rinj deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës (për arsyetimin e detajuar rreth arsyeshmërisë së Masës së Përkohshme, shih Vendimin për Masë të Përkohshme në rastin KO127/21, të 21 tetorit 2021).
122. Më 9 dhjetor 2021, Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme dhe vendosi për meritat e saj. Në po të njëjtën datë, Gjykata vendosi gjithashtu që të shfuqizojë Masën e Përkohshme.

Kërkesa për seancë dëgjimore

123. Gjykata rikujton gjithashtu që parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore.
124. Gjykata rikujton paragrafin 2 të rregullit 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës, i cili përcakton që *“Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo të ligjit.”*
125. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ai rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit. Rrjedhimisht, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur te një vendim meritator lidhur me rastin që është në shqyrtim (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës, KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110).
126. Në rastin konkret, Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth *“provave apo ligjit”* dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur meritat e këtij rasti.
127. Rrjedhimisht, Gjykata, njëzëri, e refuzon kërkesën e parashtruesve të kërkesës për caktim të seancës dëgjimore.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.5 dhe 116.2 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 27 të Ligjit, si dhe në mbështetje të rregullit 59 (1) të Rregullores së punës, më 9 dhjetor 2021:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, njëzëri, që Vendimi nr. 08/V-029 i Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. TË SHFUQIZOJË, njëzëri, Vendimin nr. 08/V-029 të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me shkarkimin e pesë (5) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- IV. TË SHFUQIZOJË, njëzëri, Vendimin për Masë të Përkohshme, të 21 tetorit 2021;
- V. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për seancë dëgjimore;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim parashtresve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, Avokatit të Popullit dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- VII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VIII. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani